Banka e Shqipërisë

ANALIZË E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO

GJASHTËMUJORI I 2017

ENIAN ÇELA
DEPARTAMENTI I POLITIKËS MONETARE

DHJETOR 2017

Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.

P E R M B A J T J A

PËRFUNDIME KRYESORE 4

1. ANALIZË E DETAJUAR E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO 5
a) Borxhi i jashtëm sipas sektorëve 6
b) Borxhi i jashtëm sipas instrumenteve të përdorura 7
c) Borxhi i jashtëm sipas maturitetit 8
d) Shërbimi i borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve 9

2. TREGUES TË QËNDRUESHMËRISË SË BORXHIT TË JASHTËM 10
a) Tregues të aftësisë ripaguese 10
b) Tregues të mjaftueshmërisë së likuiditetit 12

PËRFUNDIME KRYESORE

- Stoku i borxhit të jashtëm bruto të Shqipërisë shënoi vlerën totale prej 7,850.6 milionë eurosh në fund të muajit qershor 2017, me një rritje 0.3% në bazë vjetore. Raporti i stokut ndaj PBB- së nominale qëndronte në nivelin 70.0%, rreth 5.0 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë.
  - Në ndarjen e borxhit të jashtëm bruto sipas sektorëve, borxhi i qeverisë së përgjithshme zë rreth 43.2% të totalit, ai i korporatave depozituese 17.3%, borxhi i sektorëve të tjerë 16.5%, IHD- të huatë ndërkompani 22.3% dhe ai i autoritetit monetar 0.8%. Qeveria e përgjithshme dhe IHD-të (huatë ndërkompani) kanë dhënë ndikimet kryesore në zvogëlimin e raportit të stokut të borxhit të jashtëm ndaj PBB-së nominale.
  - Në ndarjen sipas instrumenteve të investimit, në stokun e borxhit të jashtëm dominojnë huatë dhe investimet në monedha e depozita.
  - Në ndarjen sipas maturitetit, stoku i borxhit të jashtëm përbëhet kryesisht nga borxhi afatgjatë, me rreth 79.6% ndaj totalit. Kjo peshë është pakësuar me rreth 1.2 pikë përqindje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Nga ana tjetër, pesha e borxhit afatshkurtër është zgjeruar.
- Treguesit e aftësisë ripaguese afatgjatë të borxhit të jashtëm janë përmirësuar gjatë tremujorëve të fundit.
  - Raporti ndërmjet borxhit të jashtëm bruto dhe eksportit vjetor të mallrave dhe shërbimeve u vlerësua në nivelin 183.6%, duke u zvogëluar me rreth 36.3 pikë përqindje në bazë vjetore. Megjithë përmirësimin e vënë re gjatë tremujorëve të fundit, ky tregues është përsëri mbi pragun kritik prej 150%.
- Treguesit e mjaftueshmërisë së likuiditetit dëshmojnë për presione të ulëta afatshkurtra që burojnë nga ripagimi i detyrimeve ndaj borxhit të jashtëm bruto.
  - Stoku i rezervës valutore në vendin tonë është i mjaftueshëm për të përballuar goditjet negative të mundshme nga jashtë. Kjo rezervë mbulon 6.6 muaj importe mallrash dhe shërbimesh dhe është sa 175.8% e borxhit të jashtëm afatshkurtër në fund të tremujorit të dytë 2017.

1. ANALIZË E DETAJUAR E BORXHIT TË JASHTËM BRUTO[1]

Stoku i **borxhit të jashtëm bruto** të Shqipërisë shënoi vlerën totale prej 7,850.6 milionë eurosh në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, në rritje me rreth 0.3% në terma vjetorë. Stoku aktual vlerësohet në nivelin 70.0% ndaj PBB-së nominale[2], raport ky rreth 5.0 pikë përqindje më i ulët krahasuar me atë të të njëjtës periudhë të një viti më parë.

Qeveria e përgjithshme mbetet sektori me peshën më të madhe në totalin e stokut të borxhit të jashtëm, me rreth 43.2%. Stoku përkatës u zgjerua me rreth 1.7% në terma vjetorë, duke arritur vlerën 3,391.2 milionë euro. Në raport me PBB-në nominale, stoku u vlerësua në nivelin 30.2%, rreth 1.7 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë.

Stoku i borxhit të jashtëm bruto të **korporatave depozituese (përjashtuar bankën qendrore)** rezultoi në 1,355.9 milionë euro, në rritje me rreth 4.5% krahasuar me një vit më parë. Stoku vlerësohet në nivelin 12.1% ndaj PBB-së nominale, rreth 1.1 pikë përqindje më i ulët vit mbi vit.

Stoku i borxhit të jashtëm të **sektorëve të tjerë** u vlerësua në rreth 1,296.5 milionë euro, duke shënuar një rënie prej 1.5% vit mbi vit. Pesha e tij në totalin e stokut të borxhit të jashtëm ishte 16.5%, rreth 0.3 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë.

Stoku i **huave ndërkompani të investimeve të huaja direkte** shënoi vlerën 1,747.6 milionë euro – i pakësuar me rreth 3.3% krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2016. Në raport me PBB-në nominale, stoku qëndron në nivelin 15.6%, rreth 1.7 pikë përqindje më i ulët krahasuar me gjashtëmujorin e parë 2016.

Në fund të gjysmës së parë të vitit 2017, 79.6% e stokut të borxhit vlerësohet të jetë borxh afatgjatë (përfshirë IHD-të) kryesisht në formën e huave. Borxhi afatshkurtër vlerësohet në rreth 20.4% ndaj totalit, i marrë kryesisht në formën e monedhave dhe depozitave nga sektori i korporatave depozituese (përjashtuar bankën qendrore).

[1] Të dhënat e Borxhit të Jashtëm që janë aplikuar në këtë analizë i përkasin tremujorit të dytë të vitit 2017.

[2] Shuma rrëshqitëse e PBB-së së katër tremujorëve të fundit.

A) BORXHI I JASHTËM SIPAS SEKTORËVE[3]

Stoku i borxhit të sektorit publik u zgjerua me 1.3% në bazë vjetore, me një kontribut prej 0.5 pikësh përqindje në rritjen vjetore të borxhit të jashtëm bruto.

Kontributi i **sektorit publik** (qeveri e përgjithshme dhe bankë qendrore) në rritjen e stokut total të borxhit të jashtëm është mjaft i moderuar krahasuar me të dhënat e një viti më parë. Në sektorin publik, zgjerimi i borxhit vijoi të udhëhiqet nga qeveria e përgjithshme, ndërsa banka qendrore e pakësoi ekspozimin e saj në terma të borxhit të jashtëm.

Grafik 1. Borxhi i jashtëm bruto sipas sektorëve (% ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 2. Borxhi i sektorit publik dhe privat i dezagreguar (% ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[3] Sipas M6BP, sektorët e ekonomisë i referohen: 1. qeverisë së përgjithshme; 2. bankës qendrore; 3. korporatave depozituese përjashtuar bankën qendrore; 4. sektorëve të tjerë; 5. investimeve të huaja direkte (IHD).

Sektori privat gjeneroi një kontribut negativ prej 0.3 pikë përqindjeje në rritjen vjetore të borxhit të jashtëm, gjatë periudhës në analizë. Norma zvogëluese janë vënë re në rastin e "investimet direkte-hua ndërkompani", stoku i të cilave është ngushtuar me 3.3% në terma vjetorë. Norma pozitive e rritjes është vënë re në rastin e stokut të "korporatave depozituese", ndërkohë që stoku i "sektorëve të tjerë" është ngushtuar me rreth 19.9 milionë euro krahasuar me një vit më parë.

Në një ndarje më të detajuar sipas sektorëve, historikisht stoku i borxhit të jashtëm të **qeverisë së përgjithshme** ka zënë peshën më të madhe ndaj totalit. Pjesa tjetër e stokut të borxhit është shpërndarë midis: korporatave depozituese (përjashtuar bankën qendrore) 17.3%, sektorëve të tjerë të ekonomisë 16.5%, IHD-ve (huatë ndërkompani) 22.3% dhe autoritetit monetar 0.8%.

Grafik 3. Pesha e sektorëve ndaj stokut total të borxhit të jashtëm (grafiku majtas); ndryshimet në stokun e borxhit gjatë T2 '17, krahasuar me T2 '16 (në pikë përqindje, grafiku djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

B) BORXHI I JASHTËM SIPAS INSTRUMENTEVE TË PËRDORURA

Në ndarjen sipas instrumenteve të përdorura, peshën më të madhe ndaj stokut total të borxhit të jashtëm e zënë investimet në trajtën e *investimeve të tjera*[4], me rreth 70.2% ndaj totalit (49.2% ndaj PBB-së nominale) në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017. Ky raport është pothuaj i pandryshuar krahasuar me një vit më parë. Brenda këtij zëri, peshën kryesore e zënë huatë afatgjata dhe afatshkurtra.

Duke filluar prej vitit 2008 deri në fundin e vitit 2013, pesha e këtij instrumenti në totalin e investimeve të tjera ka ndjekur prirje rënëse, në favor të instrumenteve të tjera të investimit. Gjatë vitit 2014, pesha e huave ndaj totalit të investimeve të tjera përfaqësoi mesatarisht 69.7%. Gjatë periudhës në analizë, investimet në trajtën e huave afatgjata dhe afatshkurtra përfaqësuan rreth 71.0% ndaj totalit të investimeve të tjera.

[4] Këtu përfshihen: huatë afatgjata e afatshkurtra; monedha dhe depozita; kredi tregtare; dhe detyrime të tjera të paspecifikuara të borxhit.

Ndër vite, stoku i *investimeve të huaja direkte-huave ndërkompani* ka shfaqur prirje të përshpejtuar, veçanërisht duke filluar nga tremujori i tretë i vitit 2010. Niveli më pas u stabilizua rreth vlerave 22-24%, në vitet 2014 dhe 2015. Në fund të periudhës në analizë, pesha e stokut të *investimeve të huaja direkte–huave ndërkompani* ndaj totalit të borxhit të jashtëm rezultoi rreth 22.3% - rreth 0.8 pikë përqindje më e ulët krahasuar me një vit më parë.

Investimet e portofolit përfaqësuan 7.5% të stokut total të borxhit të jashtëm bruto dhe u vlerësuan në rreth 5.2% ndaj PBB-së nominale.

Grafik 4. Borxhi i jashtëm bruto sipas instrumenteve
(në raport ndaj PBB-së, në %)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

C) BORXHI I JASHTËM SIPAS MATURITETIT

Në ndarjen sipas maturitetit, stoku i borxhit të jashtëm përbëhet kryesisht nga borxh afatgjatë (rreth 6,248.9 milionë euro). Borxhi afatgjatë (i cili metodologjikisht përfshin dhe IHD-të) përfaqësoi rreth 79.6% ndaj stokut total të borxhit të jashtëm bruto. Pesha e tij u zvogëlua me rreth 1.2 pikë përqindje në bazë vjetore. Që prej tremujorit të parë të vitit 2014, zgjerimi i borxhit të jashtëm afatgjatë ka udhëhequr prirjen rritëse të borxhit të jashtëm bruto.

Borxhi afatshkurtër shënoi një vlerë prej rreth 1,601.6 milionë eurosh në fund të gjashtëmujorit të parë 2017, duke u rritur me rreth 6.5% në bazë vjetore. Borxhi afatshkurtër ndaj totalit të borxhit të jashtëm shënoi nivelin 20.4% dhe u vlerësua në rreth 14.3% ndaj PBB-së nominale. Vetëm sektorët e korporatave depozituese dhe sektorët e tjerë të ekonomisë kanë në portofol borxh afatshkurtër. Borxhi afatshkurtër i këtyre dy sektorëve përbëhet në masën më të madhe nga instrumenti i monedhave dhe depozitave, si dhe nga instrumenti i kredive tregtare.

Grafik 5. Klasifikimi i stokut të borxhit sipas maturitetit (% ndaj PBB-së nominale)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

DJ SHËRBIMI I BORXHIT TË JASHTËM BRUTO SIPAS SEKTORËVE

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, shërbimi total i borxhit (principali dhe interesat) nga të gjithë sektorët e ekonomisë ishte 187.0 milionë euro, përafërsisht 3.2% ndaj PBB-së nominale agregate të gjashtëmujorit. Ky raport është pothuaj i njëjtë krahasuar me gjashtëmujorin e parë të vitit 2016. Në shërbimin e borxhit sipas sektorëve, pagesat e principalit përbëjnë pjesën më të madhe të pagesave. Kështu, rreth 83.7% e pagesave totale të sektorëve të ekonomisë shkoi për pagesa principali.

Tabelë 1. Shërbimi i borxhit të jashtëm dhe borxhi i ri bruto sipas sektorëve

		2014T4	2015T1	2015T2	2015T3	2015T4	2016T1	2016T2	2016T3	2016T4	2017T1	2017T2
Qeveria e përgjithshme	Pagesa principali	31.8	22.3	64.0	24.8	42.4	18.8	61.9	18.8	44.2	24.5	66.5
	Pagesa interesi	8.4	10.1	10.7	9.5	10.8	12.5	10.5	12.1	11.7	13.0	10.6
	Borxh i ri	52.9	96.2	52.9	292.3	86.5	104.4	80.6	61.2	44.2	108.8	53.4
Privat (afatgjatë dhe afatshkurtër)												
	Pagesa principali	27.6	33.9	18.0	8.2	3.4	24.4	18.9	9.6	52.7	11.2	22.2
	Pagesa interesi	2.2	2.0	0.8	0.7	0.1	1.5	2.5	1.3	2.0	2.2	1.7
	Borxh i ri	16.4	20.6	21.8	10.0	16.4	30.5	16.0	5.8	22.9	8.1	2.4
Bankat (afatgjatë dhe afatshkurtër)												
	Pagesa principali	8.8	4.4	11.4	32.6	32.6	11.9	9.2	23.2	11.2	20.3	11.7
	Pagesa interesi	0.6	0.8	0.4	0.5	0.5	0.8	0.2	0.2	0.2	1.6	1.4
	Borxh i ri	3.4	6.6	37.1	11.8	12.8	7.9	6.6	37.8	18.1	13.2	20.0
Shërbimi i borxhit të jashtëm		79.4	73.4	105.4	76.2	89.6	69.8	103.2	65.2	122.0	72.8	114.2
Borxhi i ri në total		72.7	123.5	111.9	314.1	115.8	142.8	103.2	104.8	85.2	130.1	75.8

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Borxhi i ri i marrë nga e gjithë ekonomia gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, ishte 205.9 milionë euro. Ashtu si dhe përgjatë vitit të shkuar, tërheqjet u dominuan nga borxhi i qeverisë së përgjithshme, të cilat përfaqësuan rreth 78.8% ndaj totalit të borxhit të ri të disbursuar. Borxhi i ri i marrë nga qeveria e përgjithshme ishte 12.3% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Tërheqjet në trajtën e borxhit të sistemit bankar u zgjeruan, ndërkohë që ato të sektorit privat u pakësuan në terma vjetorë.

2. TREGUES TË QËNDRUESHMËRISË SË BORXHIT TË JASHTËM

Monitorimi i qëndrueshmërisë në kohë të borxhit të jashtëm bruto ndahet në dy kategori: (a) tregues të cilët matin aftësinë ripaguese të vazhdueshme të një vendi ndaj kreditorëve të tij ndërkombëtarë; (b) tregues të cilët matin mjaftueshmërinë e likuiditetit, në kushtet e domosdoshmërisë së ripagimit të detyrimeve afatshkurtra.

Tabelë 2. Tregues të aftësisë ripaguese dhe tregues të mjaftueshmërisë së likuiditetit në vite

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017GJ1
Tregues të aftësisë ripaguese										
Borxhi i jashtëm bruto/Eksport (mallra dhe shërbime)	128.2	142.4	140.3	157.3	172.4	190.9	197.4	216.5	203.5	183.6
Borxhi i jashtëm bruto/Të ardhura fiskale	140.6	158.7	174.0	210.5	232.2	273.0	264.4	281.3	266.0	253.2
Borxhi i jashtëm bruto i qeverisë qendrore/Të ardhura fiskale	55.8	72.7	80.0	87.9	93.7	98.2	101.1	120.1	114.8	109.4
Tregues të mjaftueshmërisë së likuiditetit										
Borxhi afatshkurtër ndaj totalit	24.5	13.2	13.6	17.0	20.2	21.1	20.7	19.1	19.8	20.4
Eksport (mallra dhe shërbime)/Borxhi i jashtëm afatshkurtër	318.5	533.6	524.5	373.1	287.0	248.1	244.2	242.4	248.2	266.9
Rezerva valutore/Borxhi i jashtëm bruto afatshkurtër	205.2	348.3	342.0	226.3	177.0	149.9	152.5	197.9	188.7	175.8
Borxhi i jashtëm neto/PBB	11.9	12.1	11.7	19.0	19.5	25.6	26.9	25.3	22.0	21.5
Borxhi i jashtëm neto/Eksporte (mallra dhe shërbime)	40.3	41.5	36.1	56.0	58.5	73.8	76.5	73.3	61.0	56.2
Shërbimi i borxhit të jashtëm/Eksport (mallra dhe shërbime)[1]	3.9	5.3	11.9	7.0	8.9	8.5	9.7	10.6	9.7	9.5
Shërbimi i borxhit të jashtëm/Tërheqje e re borxhi[1]	30.8	49.0	187.1	66.0	91.3	102.7	65.6	67.4	91.5	106.1

Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.
[1] Mesatare kumulative vjetore.

A) TREGUES TË AFTËSISË RIPAGUESE

Eksporti i mallrave dhe i shërbimeve është një fluks i vazhdueshëm i të ardhurash valutore nga jashtë në një ekonomi. Raporti që kombinon këtë të fundit me borxhin e jashtëm bruto të shprehur në monedhë të huaj ndihmon në analizën e kapacitetit dhe të potencialit afatgjatë ripagues të një vendi. Përkeqësimi i këtij treguesi sinjalizon një zvogëlim të aftësisë afatgjatë ripaguese të një vendi.

Treguesi i borxhit të jashtëm bruto kundrejt eksportit të mallrave dhe të shërbimeve ka shfaqur tendenca përmirësimi prej tremujorit të tretë të vitit të kaluar. Në fund të tremujorit të dytë 2017, vlera e këtij treguesi ishte rreth 183.6%, duke u zvogëluar me rreth 36.3 pikë përqindje në nivel vjetor. Megjithë këtë përmirësim të qenësishëm, indeksi ndodhet ende lehtësisht mbi pragun teorik maksimal prej 150%[5].

[5] IMF (2003), 'External Debt Statistics: Guide for Compilers and Users', International Monetary Fund, Washington D.C. Pragu teorik maksimal ndryshon sipas zhvillimit institucional të një vendi.

Grafik 6. Borxhi i jashtëm bruto ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Fluksi i të ardhurave fiskale ndihmon në ndërtimin e dy treguesve të tjerë që matin aftësinë ripaguese të një vendi. Këto flukse duhet të mjaftojnë për të mbuluar një raport të caktuar të borxhit të jashtëm bruto dhe të stokut të borxhit të jashtëm të qeverisë qendrore. Treguesi i parë monitoron hapësirën që gëzon qeveria qendrore për të mënjanuar humbjen e besueshmërisë së vendit tek kreditorët e huaj në kohë krize, ndërsa treguesi i dytë monitoron rrezikun që të ardhurat fiskale të rishpërndahen nga shpenzime publike në fonde për amortizimin e borxhit të jashtëm publik. Raporti i borxhit të jashtëm bruto kundrejt të ardhurave fiskale vlerësohet në nivelin 253.2%6. Ky tregues është ngushtuar me 21.8 pikë përqindje krahasuar me një vit më parë. Treguesi i borxhit të jashtëm bruto të qeverisë së përgjithshme kundrejt të ardhurave fiskale ka shfaqur dinamikë të njëjtë. Raporti i regjistruar prej 109.4% rezulton rreth 7.8 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë.

Grafik 7. Borxhi i jashtëm bruto (majtas) dhe borxhi i jashtëm bruto i qeverisë qendrore (djathtas), kundrejt të ardhurave fiskale si fluks vjetor



Burimi: Banka e Shqipërisë.

6 Të ardhurat fiskale si fluks tremujor janë kthyer në flukse vjetore me anë të një shume rrëshqitëse prej katër tremujorësh.

B) TREGUES TË MJAFTUESHMËRISË SË LIKUIDITETIT

Mjaftueshmëria e likuiditetit në ekonomi, në funksion të ripagimit të detyrimeve ndaj borxhit të jashtëm, është e ndikuar nga varësia e ekonomisë prej financimit të jashtëm afatshkurtër. Metoda e financimit të jashtëm të Shqipërisë është kryesisht me borxh afatgjatë. Flukset hyrëse vjetore të të ardhurave prej eksportit të mallrave e të shërbimeve[7] arrijnë të mbulojnë tërësisht stokun e borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Gjatë tre tremujorëve të fundit, raporti midis eksportit të mallrave dhe të shërbimeve dhe borxhit të jashtëm afatshkurtër ka shfaqur prirje rritëse. Raporti ndërmjet tyre u vlerësua në 266.3% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, rreth 30.3 pikë përqindje më i lartë krahasuar me një vit më parë. Raporti i regjistruar dëshmon për mjaftueshmërinë e flukseve të rregullta hyrëse valutore në mbulimin e borxhit të jashtëm afatshkurtër.

Grafik 8. Borxhi i jashtëm bruto afatshkurtër ndaj totalit (majtas) dhe ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Një tregues tjetër i rëndësishëm është niveli i mbulimit të stokut të borxhit të jashtëm afatshkurtër prej stokut të rezervës valutore. Në kushtet e një aksesi jo të plotë në tregjet ndërkombëtare të kapitalit, rezerva valutore mund të ndihmojë në përballimin e detyrimeve afatshkurtra të borxhit të jashtëm, në raste goditjesh ekonomike të papritura.

Stoku i rezervës valutore në vendin tonë është i mjaftueshëm për të mbuluar borxhin e jashtëm afatshkurtër. Pragu kritik i këtij treguesi është 100% dhe raportet nën këtë prag dëshmojnë për një pamjaftueshmëri të stokut të rezervës valutore[8]. Që prej tremujorit të parë të vitit 2015, ky tregues është zgjeruar me ritëm të përshpejtuar vjetor, si pasojë e mjeteve më të larta valutore. Në fund të gjashtëmujorit të dytë 2017, stoku i rezervës valutore mbulonte rreth 175.8% të borxhit të jashtëm afatshkurtër.

[7] Të shprehura në shumë rrëshqitëse prej katër tremujorësh.
[8] Sipas rregullit Guidotti–Greenspan. Për më tepër: IMF, "Assessing reserve adequacy", 2011.

Grafik 9. Stoku i rezervës valutore kundrejt borxhit të jashtëm bruto afatshkurtër



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Borxhi i jashtëm neto ndihmon në monitorimin e presioneve afatshkurtra, si rezultat i detyrimeve të pritshme brenda një viti. Borxhit të jashtëm bruto i hiqet vlera kumulative e mjeteve valutore të bankave dhe e rezervës valutore. Në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, borxhi i jashtëm neto u vlerësua në nivelin 21.5% ndaj PBB-së nominale, rreth 4.1 pikë përqindje më i ulët krahasuar me një vit më parë. Treguesi i borxhit të jashtëm neto ndaj eksportit të mallrave dhe të shërbimeve u vlerësua në nivelin 56.2% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, duke u pakësuar me rreth 19 pikë përqindje në bazë vjetore.

Grafik 10. Borxhi i jashtëm neto ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (djathtas)

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Treguesit e ndërtuar mbi bazën e fluksit të rregullt të pagesave të principalit dhe të interesit ndihmojnë në monitorimin e presioneve mbi financat e vendit prej shërbimit të borxhit të jashtëm. Niveli i amortizimit është i lidhur ngushtë me maturitetin e borxhit të jashtëm dhe me kohëzgjatjen e periudhës ku ekzistojnë

lëshime të përkohshme ndaj pagesave të interesit dhe të principalit mbi borxhin. Një tregues i monitoruar është raporti i madhësisë relative të shërbimit të borxhit të jashtëm kundrejt flukseve hyrëse valutore prej eksportit të mallrave dhe të shërbimeve. Ky tregues ishte në nivelin 10.0% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit, duke u ngushtuar me rreth 1.1 pikë përqindjeje në nivel vjetor. Raporti i regjistruar i këtij treguesi ndodhet ndjeshëm nën pragun kritik prej 20%, të sugjeruar prej organizmave financiare ndërkombëtare[9].

Treguesi i raportit të amortizimit të borxhit të jashtëm kundrejt tërheqjes së borxhit të ri, mat zëvendësimin e pjesës së borxhit të ripaguar me tërheqje të re borxhi. Për këtë tregues, raporti nën kufirin 100% tregon një tërheqje më të përshpejtuar të borxhit të ri të jashtëm, krahasuar me pagesat e kryera për amortizimin e tij. Raporti i zëvendësimit të borxhit të jashtëm ishte në nivelin 151.6% në fund të gjashtëmujorit të parë të vitit dhe mesatarisht 106.1% për katër tremujorët e fundit. Faktorët respektivë të zëvendësimit të borxhit të amortizuar me borxh të ri do të ishin respektivisht 0.7 dhe 1.0.

Grafik 11. Raporti i shërbimit të borxhit të jashtëm ndaj eksportit të mallrave e shërbimeve (majtas) dhe ndaj tërheqjes së borxhit të ri (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

[9] IMF (2003), "External Debt Statistics: Guide for Compilers and Users", International Monetary Fund, Washington D.C.